



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Raporti mujor: Për muajin Qershor-2016

POZICIONI : Basri Hashani, drejtor i DRSK-së

1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1,1 – Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Procedurë	Të Pazgjidhura
10	9	-	1	-

Tabela-1.2 – Pasqyra e lëndëve të pranuar nga palët dhe të shqyrtuara

Nr.	Përshkrimi	Kërkuesi	
1.	Dhënjën e sallës në shfrytzim	Qerdhes së fëmijëve "Ardhmërija jonë"	Pëlqim
2.	Dhënjën e sallës në shfrytzim	Sh.F.M.U."Vllazërit Frashëri"	Pëlqim
3.	Dhënjën e sallës në shfrytzim	Klubit të Pingpongut „ULPIANA” nga Lipjani	Pëlqim
4.	Dhënjën e sallës në shfrytzim	Agim Sylejmani Promovimi i Librit Monografia e Sadik Bujës	Pëlqim

Vërejtje : Lëdet tjera janë në Zyren e Kryetarit ose të Aprovuara ose në Procedurë.

Tabela- 2 Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vrejtje
11	11	61	-	Janë inkasuar 30.5€

Tabela-3 Raporti për muajin prill për Bibliotekën e Qytetit dhe Bibliotekat në teren

Libra në huazim dhe të kthyera	Lexues te rinjë	Përpunimi i librit	Lexus në sallën e leximit
1236	171	23	388

*Kemi punuar raportin për muajinMaj

*Drejtoria per Kulturë, Rini dhe Sport me gjithë sektoret e vet hartoi projekt propozimin për „**Javen e Kultures 2016**” dhe pas konsultimit me kryetarin e komunes projekt propozimi i si i tillë mori perkrahen për t’u realizuar.

Aktivitetet filluan me Diten Ndërkombëtare të Fëmijeve me 1 Qershor ku me këtë rast Kryetari i Komunes priti një delegacion të fëmijëve nga SHFMU “Ismail Luma” - Lipjani.

Në bashkëbisedim me femijet Kryetari i Komunes foli per historikun e konventes ndërkombëtare të femijeve të miratuar nga Asambleja e Kombeve te Bashkuara, njëherit për fëmijët u organizua një koktej rasti ,ndërsa në ora 16.00 në po këtë ditë u mbajt koncert festiv në Sheshin „Adem Jashari” në Lipjan , **Me program Kulturoro Artistik** u prezentuan dy Shkollat Fillore të qytetit, shkolla fillore e Llugaxhisë dhe Qerdhet „Ardhmëria Jonë” e qytetit të Lipjanit organizuar enkas për fëmijët të cilët ishin prezent një masë e madhe e fëmijëve dhe qytetareve tjerë të qytetit të Lipjanit me rrethinë.

Më datë 6,7 dhe 8 qershor 2016 në Qendren Kulturore “Tahir Sinani” janë shfaqë 3 Filma në bashkëpunim me OJQ „Art Line “,pjesëmarrja ka qenë e kënaqeshme

Më 9 qershor në ambientet e Sallës së Kuvendit në bashkëpunim me Klubin Letrarë „Fazli Grajqevci” është mbajtur Orë letrare ku Juria profesionale ka shpërblyert tre POEZITË më të mira dhe më pas është bërë edhe promovimi i Librit „**Arsimi shqip në Lipjan dhe rrethin gjatë viteteve 1990-2008**” i autorit Astrit Buja.

Më 10 qershor sektori për Rini në bashkëpunim me KVRL organizoj një mori aktivitete në lëmin e sporteve atraktive të cilat u realizuan në Qendrën Kulturore “Tahir Sinani” Lipjan , ndërsa nën përkuqjesjen gjithashtu të sektorit të rinisë në bashkëpunim me KVRL – në u organizuar Mbrëmje Rinore me rinin Lipjanase në kafeterinë”Roum”

Më 12 qershor në sallën e Kuvendit është organizuar Mbledhje Solemne ,

Pas Mbledhjes DKRS ka organizuar një Koktej rasti për të pranishmit .

Kurse më pas ne Qendren Kulturore “Tahir Sinani”u mbajt koncert festiv për Diten e Çlirimit të Lipjanit ku kanë përformuar Grupi nga AKV „Lipjani” , grupi i instrumentisteve te vegjel nga Lipjani ,Rapsodet Vëllezërit Murati si dhe këngëtarja e mirënjohur e Estrades Kosovare Aferdita Demaku .

Më 13 qershor duke filluar në ora 17:00 në Qenderen Kulturore „Tahir Sinani” grupi i Artisteve të ri nga Lipjani në bashkëpunim me OJQ „ART LINE” dhe DKRS-në kanë dhënë shfaqjen me **titull „7 vjetë “** ,pjesëmarrja e shikuesve ishte e mirë .

Më 14 qershor duke filluar në ora 9:00 përfaqësuesit e ekzekutivit dhe legjlistativit të kryesuar nga Kryetari i Komunës kanë bërë homazhe në Komplekset memoriale dhe te Lapidarët e Dëshmorëve me rastin e ditë së Dëshmorëve .

Gjithashtu më 14 qershor duke filluar në ora 11:30 është mbajtur Akademia perkujtimore per Deshmoret e komunes se Lipjanit e cila u mbajt ne sallen e kinofikimit ne Lipjan ku me kete rast falen Kryetari i Komunës ,Krye imami i Bashkësisë Islame në Lipjan dhe Përfaqësuesi i Shoqatave të dalura nga Lufta e UÇK-së dhe me performancën e vet aktorja e re Adelina Tërshana me një monolog për Dëshmorët dhe Arbeni Krasniqi nga fshati Smallusha me një monolog „Një grushtë dhe për atëdhe”

Në fund në shenjë respekti për të gjithë familjarët e Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit DKRS ka organizuar një Iftar.

***Më 23 qershor** në bashkëpunim me Klubin e Basketbollit „LIPJANI” kemi organizuar Panairin e Sportit 2016 aktivitet ky I cili u organizua në bashkëveprim me Komitetin Olimpik të Kosovës .

*Në këtë Panair kanë prezantuar punën dhe aktivitetet e veta sportive Klubet Sportive të Komunës së Lipjanit para fëmijëve dhe të rinjve tjerë të cilët u interesuan për aktivitetet e tyre.

***Gjatë** këtij muaji kemi nënshkruar një marrveshje me Ministrin e Diaspores për zhvillimin e disa aktiviteteve me rastin e Ditëve të Diaspores me titull „TI JE PJESË E ATDHEUT” ,aktivitet tash më tradicional për nderë të mërgimtarëve .

***Takim pune** me përfaqësuesin e OJQ „PEN “ z. Valon Nushi lidhur me mundësin e hapjen e Qendres Rinore në fshatin Shalë ,project ky I cili do të ndihmohet nga UNICEF.

***Kemi bërë** kërkesë Drejtorisë së Prokurimit për zhvillimin e procedurave të tenderimit për ndërtimin e Stadionit të Qytetit faza e dytë ,project ky I cxili do të vazhdoj në vitet në vijim.

*Kemi marrë pjesë në ceremonin e shpërblimeve nga rrjeti I edukatorëve Bashkmoshatar PEN ,me mbeshtetje nga IFES dhe USAID .

Ku me këtë rast janë shpërblyer tre të rinj nga komuna e Lipjanit .

*DKRS në bashkëpunim me Dretoratin e Zhvillimit Ekonomik ,Drejtoratin e Bujqësisë ka marrur pjesë në Panairin e organizuar nga Asociacioni I Komunave të Kosovës me rastin e 15 vjetorit të formimit të këtij Asociacioni.

*Në Qendren Kulturore„Tahir Sinani” është promovuar Libri i autorit Agim Sylejmani me titull „Pergamenë e gjallë” monografi kushtuar veprimtarit Sadik Buja.

* Në Arkivin qytetit është punuar në sistemimin dhe ndarjen e dokumentacionit në vite të Ndërrmarrjes „KosovaTrans” nga Lipjani ku janë ndarë sipas viteve në 105 regjistrator.